



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 138, datë 28.10.2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROÇEDURAT E ZHVILLIMIT TË
SHORTEUT PUBLIK MANUAL NË BASHKINË DURRËS
NË KUADËR TË RINDËRTIMIT

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, dhe sipas relacionit hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullores për procedurat e zhvillimit të shorteut publik manual në Bashkinë Durrës në kuadër të rindërtimit sipas dokumentacionit bashkëngjitur.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Durrës, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2021



RREGULLORE PËR PROÇEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTEUT PUBLIK MANUAL
NË BASHKINË DURRËS NË KUADËR TË RINDËRTIMIT

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 13.10.2021 "Për disa shtesa në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar

KËSHILLI BASHKIAK DURRËS

VENDOSI

Neni 1
Objekti

Kjo rregulore përcakton procedurat e shorteut publik manual:

- a. Përcaktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve sipas nenit 12 të Vkm nr. 904 datë 24.12.2019:
 - a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
 - b) familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
 - c) familjet që kanë në përbërje personat me aftësitë kufizuara;
 - ç) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
 - d) familjet në skemën e ndihmës ekonomike;
 - dh) të rënë në krye të detyrës.
- b. Përcaktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 1+1 (pronarë të njësive të banimit të objekteve të shembura në trojet e të cilëve janë ndërtuar objektet e reja)
- c. Përcaktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 2+1 (pronarë të njësive të banimit të objekteve të shembura në trojet e të cilëve janë ndërtuar objektet e reja)
- d. Përcaktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 3+1 (pronarë të njësive të banimit të objekteve të shembura në trojet e të cilëve janë ndërtuar objektet e reja)

- e. Për caktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 1+1 (që kanë nënshkruar marrëveshjen paraprake)
- f. Për caktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 2+1 (që kanë nënshkruar marrëveshjen paraprake)
- g. Për caktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 3+1 (që kanë nënshkruar marrëveshjen paraprake)
- h. Për caktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 1+1
- i. Për caktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 2+1
- j. Për caktimin e apartamenteve / njësisë së banimit të përfituesve të strukturës 3+1

Neni 2 **Parimet**

Kjo rregullore bazohet në parimin e transparencës, mosdiskriminit, mundësisë së aksesimit dhe kuptimit për përfituesit, njoftimit, barazisë ndërmjet përfituesve të të njëjtit grup.

Neni 3 **Organizimi i shorteut publik**

Procedurat e shorteut realizohen në prani të gjithë subjekteve përfitues.

Shorteu drejtohet nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore, me ndihmën e Komisionit të Posaçëm.

Subjektet përfituese informohen / njoftohen / thirren për njoftimin e përgjithshëm të shorteut por edhe nga thirrja nëpërmjet njoftimit të cdo përfaqësuesi, pjesë e shorteut publik.

Njoftimi duhet të jetë i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga të gjithë dhe bëhet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së hedhjes së shorteut nëpërmjet lajmërimeve publike. Këto të fundit publikohen apo afishohen në ambientet publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale, si edhe botohen në gazetatat lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Ky njoftim duhet të përmbajë listën e përfituesve dhe vendndodhjen / zonën e objektit.

Thirrja do të përmbajë:

- a. Njësinë e vetëqeverisjes vendore që e ka nxjerrë,
- b. Emrin, mbiemrin e personit të thirrur, përfitues nga program i rindërtimit,
- c. Vendndodhjen / zonëkuështë / janë ndërtuar objekti / objektet ose zona sipas marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë.
- d. Vendin dhe datën e organizimit të këtij shorteu publik,
- e. Si edhe pasojat në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në shorte.



Njoftimi shkresor nëpërmjet letërthirrjes bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi i njësisë vendore ose shërbimit postar. Lidhur me njoftimin apo thirrjen mbahen në konsideratë dispozitat e ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Neni 4

Procedura e shorteut publik

1. Procedura për hedhjen e shorteut publik zhvillohet në mjedise të përcaktuara sipas njoftimit dhe thirrjes.
2. Në çdo procedurë shorteu publik mbahet një procesverbal si edhe një regjistër ku identifikohen të dhënat dhe rezultatet e shorteut.
3. Detyrat e mësipërme realizohen nga Komisioni i Posaçëm.

Neni 5

Procedura e shorteut publik në rastet e objekteve të reja të ndërtuar në truallin e objekteve të shëmbura

Shorteu për caktimin e apartamenteve / njësisve të banimit të përfituesve në objektet e reja të ndërtuara në truallin e objekteve të shëmbura organizohet sipas përcaktimeve të neneve 2, 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje.

Përfituesit në këto objekte do të verifikohen nëpërmjet mjetit të identifikimit ose prokurës së përfaqësimit dhe do të ndahen fillimisht sipas strukturës së apartamenteve.

Për çdo strukturë apartamenti, subjektet përfituese do të renditen sipas rendit alfabetik kategoritë e prioritetit të përcaktuar në pikën 12 të VKM 904 datë 24.12.2019, i ndryshuar, pronarët e njësisve të banimit të objekteve të shëmbura në trojet e të cilëve janë ndërtuar objektet e reja, subjektet përfituese që kanë nënshkruar marrëveshjen paraprake.

Në shiritat e letrave shënohet: Numri i apartamentit, kati, hyrja dhe nr i godinës.

Komisioni i Rindërtimit organizon punën për sa më sipër në bashkëpunim me strukturat e rindërtimit të Bashkisë Durrës.

Në këtë shorte publik pasi verifikohen numrat e apartamenteve në shirita nga Komisioni i Posaçëm dhe nga të gjithë pjesmarrësit në shorte Kryetari i palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat vendosen në shporta të cilat i referohen disa karakteristikave sipas edhe përfituesve si më poshtë:

- a. një shportë për përfituesit për strukturën 1+1

b. një shportë për përfituesit për strukturën 2+1

c. një shportë për përfituesit për strukturën 3+1

Goglat përpara së të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë edhe nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm nëse e shohin të nevojshme të verifikojnë njëtrajshmërinë dhe barazinë e tyre në formë apo temperaturë.

Renditja e subjekteve përfituese do të realizohet fillimisht sipas kategorisë së përparësisë për çdo strukturës së banimit për të cilët janë kualifikuar.

Komisioni i Posaçëm siguron nëpërmjet administratës së Bashkisë projektin skematik sipas hyrjeve strukturave dhe kateve. Ky projekt duhet të jetë prezent i vendosur në mënyrë të dukshme gjatë hedhjes së shorteut publik.

Pasi bëhet përzierja e goglave në kutinë apo globin transparent subjekti përfitues tërheq në mënyrë rastësore një gogël, e hap dhe lexon emrin me zë të lartë e tregon shiritin i cili përmban të dhënat e përfituesit dhe e dorëzon Kryetarit të Komisionit, i cili e vendos në projekt skice / si edhe shënohet në procesverbalin dhe regjistrin e shorteut publik nga Komisioni i Posaçëm.

Në rast se njëri nga subjektet përfitues nuk është prezent në ditën e hedhjes së shortit, përzgjedhja e gogles do të realizohet nga Kryetari i Komisionit të Posaçëm.

Në përfundimin e zgjedhjes rastësore të çdo gogle të hedhura në globin apo kutinë transparente në përfundim të goglave që përmban një shportë bëhet edhe shpërndarja në projekt skicën e numërtuar të objektit / pallatit / godinës së banimit.

Ky proces transparent ndiqet dhe bëhet për të gjitha shportat aq sa gogla janë të përfshira në shorte dhe derisa të bëhet shpërndarja e tyre rastësore në të gjithë objektin / pallatin / godinë në banimit. Çdo gogle të zgjedhur në mënyrë rastësore i përkon një njësi banimi / apartament në objektin / pallatin / godinën e banimit.

Në përfundim të procedurës së shorteut përfituesit mund të ndryshojnë ndërmjet tyre njësitë e banimit / apartamentet sipas kateve të përcaktuara në shorte. Pra nëse dikush që sipas shorteut i ka rënë kati i pestë mund ta ndryshojë me atë të katit të katërt (kur bëhet fjalë për të njëjtën strukturë banimi) me dakordësinë e të dyve të shprehur sipas legjislacionit në fuqi.

I gjithë procesi pasqyrohet në regjistrin dhe procesverbalin e shorteut dokumenta të cilat përpilohen nga Komisioni i Posaçëm.

Neni 6

Procedura e shorteut publik në rastet e objekteve të reja në zonat e reja për zhvillim

Shorteu për caktimin e apartamenteve / njësive të banimit të përfituesve në objektet e reja të ndërtuara në truallin e objekteve të shëmbura organizohet sipas përcaktimeve të neneve 2, 3 dhe 5 të kësaj rregulloreje.

Përfituesit në këto objekte do të verifikohen nëpërmjet mjetit të identifikimit ose prokurës së përfaqësimit dhe do të ndahen fillimisht sipas strukturës së apartamenteve. Për çdo strukturë

apartamenti, subjektet përfituese do të renditen sipas kategorisë së prioritetit të përcaktuar në pikën 12 të VKM 904 datë 24.12.2019, i ndryshuar, dhe pjesa e mbetur sipas rendit alfabetik.

Në shiritat e letrave shënohet: Numri i apartamentit, kati, hyrja dhe nr i godinës.

Komisioni i Rindërtimit organizon punën për sa më sipër në bashkëpunim me strukturat e rindërtimit të Bashkisë Durrës.

Në këtë shorte publik pasi verifikohen numrat e apartamenteve në shirita nga Komisioni i Posaçëm dhe nga të gjithë pjesmarrësit në shorte Kryetari i palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat vendosen në shporta të cilat i referohen disa karakteristikave sipas edhe përfituesve si më poshtë:

a. një shportë për përfituesit për strukturën 1+1

b. një shportë për përfituesit për strukturën 2+1

c. një shportë për përfituesit për strukturën 3+1

Goglat përpara së të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë edhe nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm nëse e shohin të nevojshme të verifikojnë njëtrajshmërinë dhe barazinë e tyre në formë apo temperaturë.

Renditja e subjekteve përfituese do të realizohet fillimisht sipas kategorisë së përparësisë për çdo strukturës së banimit për të cilët janë kualifikuar.

Komisioni i Posaçëm siguron nëpërmjet administratës së Bashkisë projektin skematik sipas hyrjeve strukturave dhe kateve. Ky projekt duhet të jetë prezent i vendosur në mënyrë të dukshme gjatë hedhjes së shorteut publik.

Pasi bëhet përzjerja e goglave në kutinë apo globin transparent subjekti përfitues tërheq në mënyrë rastësore një gogël, e hap dhe lexon emrin me zë të lartë e tregon shiritin i cili përmban të dhënat e përfituesit dhe e dorëzon Kryetarit të Komisionit, i cili e vendos në projekt skice / si edhe shënohet në procesverbalin dhe regjistrin e shorteut publik nga Komisioni i Posaçëm.

Në rast se njëri nga subjektet përfitues nuk është prezent në ditën e hedhjes së shortit, përzgjedhja e goglës do të realizohet nga Kryetari i Komisionit të Posaçëm.

Në përfundimin e zgjedhjes rastësore të çdo gogle të hedhura në globin apo kutinë transparente në përfundim të goglave që përmban një shportë bëhet edhe shpërndarja në projekt skicën e numërtuar të objektit / pallatit / godinës së banimit.

Ky proces transparent ndiqet dhe bëhet për të gjitha shportat aq sa gogla janë të përfshira në shorte dhe derisa të bëhet shpërndarja e tyre rastësore në të gjithë objektin / pallatin / godinë në banimit. Çdo gogle të zgjedhur në mënyrë rastësore i përkon një njësi banimi / apartament në objektin / pallatin / godinën e banimit.

Në përfundim të procedurës së shorteut përfituesit mund të ndryshojnë ndërmjet tyre njësitë e banimit / apartamentet sipas kateve të përcaktuara në shorte. Pra nëse dikush që sipas shorteut i ka rënë kati i pestë mund ta ndryshojë me atë të katit të katër (kur bëhet fjalë për të njëjtën strukturë banimi) me dakordësinë e të dyve të shprehur sipas legjislacionit në fuqi.

I gjithë procesi pasqyrohet në regjistrin dhe procesverbalin e shorteut, dokumenta të cilat përpilohen nga Komisioni i Posaçëm.

Neni 7


Hyrja në fuqi dhe aplikime

Rregullorja e shorteut publik hyn në fuqi pas miratimit nga Këshillit Bashkiak Durrës.

Kjo rregullore e shorteut publik nuk aplikohet në rastet kur të gjithë subjektet përfituese të objekteve të reja të ndërtuara në të njëjtin truall kanë shprehur dakordësinë sipas ligjit për shpërndarjen e apartamenteve / njësive të banimit.

Kjo dakordësi duhet të jetë e shprehur përpara një noteri publik specifikisht nga çdo përfitues në një akt të përbashkët noterial në përputhje me legjislacionin në fuqi.





3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 864 / prot.
2

Durrës, më 29 . 10 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.138 datë 28.10.2021 “Për miratimin e rregullores për procedurat e zhvillimit të shorteut publik manual në Bashkinë Durrës në kuadër të rindërtimit”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

